V E N D I M
Nr. 376, datë 27. 5. 2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 612, DATË 29.12.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR DHE SHTESË PENSIONI TË POSAÇËM ", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR. 94, DATË 6.2.1995 DHE NR. 635, DATË 27.2.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 5 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit nr. 152, datë 5.4.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i punës dhe Çështjeve Sociale , Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shkronjën "b" të pikës 1 të vendimit nr. 612, datë 29.12.1994 të Këshillit të Ministrave , fjalia e fundit ndryshohet si vijon :

"b) Shtesa e pensionit shtetëror të jetë 8 800 (tetë mijë e tetëqind) lekë në muaj."

2. Efektet financiare shtrihen nga data 1.1.2001 dhe të përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta